
	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina	
-----------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------

Datë/a:	05.06.2020
Për/ Za/ To:	“Pevlaku-Dega në Kosovë”
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për rishqyrtim** të datës 02.06.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “Pevlaku-Dega në Kosovë”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Tregu i ri i qytetit, me Nr. të Prok: 616 19 9686 511 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga “Pevlaku-dega në Kosovë” e dates 02.06.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Tregu i ri i qytetit”, me Nr. të Prok: 616 19 9686 511, kundër Vendimit të AK –së, të datës 28.05.2020.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë aktivitetin e prokurimit me titull “Tregu i ri i qytetit”, me Nr. të Prok: 616 19 9686 511 sipas njoftimit të dates 28.05.2020.
3. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës me datë 03,04 dhe 05.06.2020 ka shqyrtuar kërkesën e grupit të OE-ik “Pevlaku-Dega në Kosovë” dhe lidhur me pretendimet e të njejtit ka konstatuar si vijon:

-Pretendimi i parë se marrëveshja e konzorciumit i grupit të OE-ik “Fidola&Nartel Exin” nuk përmban emrin dhe numrin e tenderit është e pa bazuar pasi që Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar që këto të dhëna të shënohen në të njejtën, ndërsa pretendimi se nuk janë përcaktuar qartë deklarimet lidhur me obligimet e anëtarëve për pjesëmarrje dhe realizim të projektit ju

sqarojmë se këto janë të përcaktuara qartë në pikat 4,5,dhe 6 të marrëveshjes,ndërsa deklarimet se nuk do të marrin pjesë si të vetëm apo si anëtar të ndonjë konzorciumi tjetër janë të paraqitura ndaras nga të dy anëtarët e grupit;

-Pretendimi se Deklarata nën betim e anëtarit të konzorciumit "Nartel Exin" nuk është me datë të shënuar nuk paraqet kurrfarë lëshimi,pasi që është dorëzuar me tërë ofertën e grupit të OE-ik dhe natyrisht nuk mund të ketë datë tjetër,pos datën e dorëzimit;

-Pretendimi se grupi i OE-ik "Fidola&Nartel Exin" nuk ka dorëzuar deklaratë për specifikimet teknike ju sqarojmë se as në njoftimin për kontratë e as në dosje Autoriteti Kontraktues askund nuk ka paraqitur kërkesë se një deklaratë e tillë duhet të dorëzohet dhe si që e dini edhe ju e edhe tenderuesit tjerë vlerësimi i tenderit bëhet vetëm sipas kërkesave të dosjes dhe nuk lejohet vlerësimi sipas kriteteve që nuk janë dhënë në të njejten;

-Pretendimi tjetër se grupi i propozuar për dhënje të kontratës nuk ka dorëzuar të gjitha çertifikatat e kërkuara ju sqarojmë se është i pa qëndrueshëm,pasi që çertifikatat e dorëzuara janë në përputhje me kërkesat e paraqitura në Njoftimin për korigjimin e gabimeve ku është cekur se dy çertifikatat:ISO 27001 2013 dhe PAS 99 2012 nuk kërkohen ;poashtu çertifikatat kanë qenë valide me datën e dorëzimit dhe dorëzimi i çertifikatave origjinale natyrisht që është më shumë apo së paku i barasvlershëm me çertifikata e noterizuara;

-Lidhur me pretendimet se ky grup i OE-ik ,respektivisht lideri nuk ka plotësuar kërkesat e qarkullimit financiar ju sqarojmë se Autoriteti Kontraktues ka verifikuar të gjitha dokumentet e dorëzuara dhe në bazë të sqarimeve të verifikuara edhe nga banka është konstatuar se i njejt i plotëson edhe kërkesat nga pika 9.1 edhe nga pik 9.2 e FDT-së.Ua përkujtoj se të gjitha komunikimet dhe dëshmite u janë dorëzuar edhe ju në CD;


-Lidhur me stafin dhe kontratat e tyre ju sqaroj se nuk është kërkuar kohëzgjatja e atyre kontratave dhe për Autoritetin Kontraktues duke marre parasysh edhe sqarimet nga konzorciumi gjate fazes se vleresimit janë të mjaftueshme dhe në harmoni me kërkesat tona.

Bazuar në komentet paraprake konstatoj se pretendimet tuaja jane te pa bazuara dhe kerkesa juaj eshte refuzuar.

Bazuar në sqarimet e dhena u vendos si në dispozitiv të Vendimit.

Këshillë juridike:Pala e pakënaqur me Vendimin mund të parashtroj ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit në afat prej dhjetë(10)ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Udhëheqësi i Prokurimit


(Zekë Bardhaj)